Raporti i II-të periodik i monitorimit të zbatimit buxhetit Janar – Gusht 2021

Me vendimin nr.169 date 23.12.2020, është miratuar nga Këshilli i Bashkisë Kukës programi buxhetor dhe detajimi i tij për Bashkinë Kukës, për vitin financiar 2021 dhe po kështu edhe programi buxhetor dhe detajimi i tij për periudhën Janar – Gusht 2021, vendim i cili është konfirmuar nga institucioni i Prefeketit të Qarkut Kukës me shkresen nr 1/89 prot. date 05.01.2021 ”Verifikim i ligjshmërisë së akteve”, ky detajim për vitin 2021 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, si dhe në prioritetet e përcaktuara nga Bashkia Kukës.

Detajimi i fondeve për vitin 2021 është realizuar sipas programeve buxhetore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimet, produktet dhe përfituesit, nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program, të parashikuar në PBA për periudhën 2022-2024.

Edhe pse sot që raportojmë jemi në një situatë shëndetsore më të lehtësuar, duhet theksuar se muajt e parë të vitit 2021, për popullsinë e Bashkisë Kukës për shkak të Pandemisë covid-19 dhe si rrjedhojë e saj, situata ka qenë problematike, prandaj për ne ka qenë detyrim që të kufizojmë sa të mundim aksesin në ambiente publike, të ndalojmë konsultimet publike në salla, të kufizojmë aktivitetet në minimumin e domosdoshëm. Megjithatë Bashkia Kukës nëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të Bashkisë në mënyrë të vazhdueshme e ka informuar publikun në lidhje me raportet periodike të monitorimit të buxhetit për periudhat katërmujore dhe raportin e konsoliduar vjetor, si dhe raportin e treguesve të performancës.

Ashtu si raportet e mëparshme edhe Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Gusht 2021, është hartuar duke respektuar distancimin social dhe komunikimin me mjetet elektronike.

Raporti përfshin informacion mbi realizimin e zbatimit të buxhetit në mënyrë të përmbledhur dhe ka ruajtur të njejtën **përmbajtje:**

Përmbajtja

1. Përmbajtja e raportit dhe lista e dokumentave shoqërues;
2. Hyrje;
3. Hapat e ndjekur në proçesin e monitorimit të Buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2021;
4. Plotësimi i formateve të përcaktuara (të gjitha anekset bashkëlidhur), ku të dhënat janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kukës, si për planin e buxhetit dhe realizimin faktik të shpenzimeve sipas Sistemit Informacionit Financiar të Qeverisë (SIFQ);
5. Raporti i shpenzimeve të Bashkisë Kukës **sipas programeve** (Aneksi nr.1)
6. Raporti i shpenzimeve të programeve **sipas artikujve buxhetorë** (Aneksi nr.2)
7. Raporti i **treguesve të performancës** (Aneksi nr.4)
8. Raporti i realizimit të **treguesve financiarë** (Shtojca 5)
9. Relacion shpjegues për çdo format të sipërpërmendur (Shtojca 2)
10. Projektet **e investimeve** të Bashkisë Kukës (Aneksi nr. 5)

Hyrje

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 48, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit nr.22 date 30.07.2018 "Për proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", është hartuar dokumenti i Raportit të konsoliduar vjetor i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Gusht 2021, raport i cili informon Anëtarët e Këshillit të Bashkisë Kukës dhe të gjithë qytetarët mbi përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të Administratës së Bashkisë Kukës, mbi përdorimin e fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçiencë për garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Gusht 2021.

Në aspektin e organizimit administrativ, Bashkia e Kukësit përfshin në administrimin e vet Bashkinë qendër dhe 14 Njësi Administrative. Duke u bazuar në klasifikimin e ri të të zonave urbane dhe rurale, Bashkia Kukës dallohet për karakterin e saj rural. Ajo përfshin 1 qendër urbane dhe 14 zona rurale. Nga pikëpamja e madhësisë së territorit, pjesa më e madhe i përket Njësisë Administrative Malzi, më përkatësisht 16.58 % të territorit e ndjekur nga Grykë Çajë me 9.97 %. Ndërsa pjesën më të vogël e zë qyteti i Kukësit me përkatësisht 1.41 % të totalit të territorit të Bashkisë së Kukësit.

Qendra kryesore e Bashkisë Kukës është Qyteti i Kukësit dhe është qendra më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaj, Shtiqën, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Qyteti i Kukësit është vendi ku zhvillohet aktiviteti më i madh prodhues ekonomik, social-kulturor, tregtar, sportiv etj.

Sa i takon hapave të ndjekur në proçesin e monitorimit të Buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Gusht 2021 janë të njejtë, kështu janë ndjekur fazat e hartimit dhe përgatitjes së buxhetit dhe hapat që parashikon udhëzimi nr.23 date 30.07.2018 "Për proçedurat standarde të hartimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", për fazën e parë:

- Përgatitja dhe shpërndarja e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i buxhetit vjetor
- Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave
- Udhëzimi vjetor i ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit vendor
- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm
- Udhëzimi i kryetarit të njësisë vendore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm

- Përgatitja e kërkesave buxhetore mbi bazën e tavaneve paraprake
- Përgatitja e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm

Dhe për fazën e dytë:

- Përgatitja dhe shpërndarja e udhëzimit plotësues për Programin Buxhetor Afatmesëm
- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar
- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar

Kurse sa i takon këtyre proçedurave në Bashkinë Kukës, janë ndjekur me korrektësi hapat që parashikon udhëzimi nr.22 date 30.07.2018 "Për proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" si më poshtë:

- Procesi i raportimit mbi performancën për secilin program.
- Ecuria e treguesve të monitorimit të performancës së programeve.
- Raporti mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të performancës së programeve.
- Ndryshime të mundshme në strukturën e planit të shpenzimeve.
- Masa e realizimit në përqindje të treguesve të performancës.
- Monitorimi i treguesve të performancës së programeve buxhetore sipas standardeve.
- Relacion shpjegues për mospërputhjet kundrejt planit të periudhës raportuese.
- Masat korrigjuese që duhen ndërmarrë në rast mospërputhjeje.
- Masat që kërkojnë vendimmarrje të kryetarit të Bashkisë apo Këshillit të Bashkisë.
- Transferim fondesh ndërmjet njësive shpenzuese të Bashkisë.
- Rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program.
- Raportet e monitorimit të të tre katërmujorëve përmblidhen në një raport përfundimtar monitorimi, i cili i dërgohet Këshillit të Bashkisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në hartimin e raportit mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas programeve, kanë shërbyer së pari tabelat e anekseve përkatëse dhe ilustrimet me grafiqet si më poshtë dhe bashkë me to dhe relacioni shpjegues i shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas programeve apo siç njihen në raportim aneksi nr.1 dhe shtojca nr.2.

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

Periudha Janar – Gusht 2021 — ne 000/leke

Emri i Grupit		Kodi i Grupit	

Programet		Shpenzimet e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli		Fakti i vitit paraardhes	PBA Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	Fakti i Periudhes/progresiv	Diferenca
01110	01110 - Administrata	276,070.69	283,864.32	284,118.47	0.00	284,118.47	170,685.92	-113,432.55
06260	06260 - SHERBIMET	150,232.26	125,247.68	155,786.68	0.00	155,786.68	114,982.83	-40,803.85
01170	01170 - GJENDJA CIVILE	11,105.38	8,450.00	8,450.00	0.00	8,450.00	5,598.03	-2,851.97
03280	03280 - MZSH	41,823.06	57,469.42	57,469.42	0.00	57,469.42	28,007.73	-29,461.69
04130	04130 - QKB	1,333.47	1,575.00	1,575.00	0.00	1,575.00	954.15	-620.85
04240	04240 - UJITJA DHE KULLIMI	11,870.93	10,921.20	15,115.07	0.00	15,115.07	6,417.19	-8,697.88
04260	04260 - SHERBIMI PYJOR	8,776.34	15,115.07	10,921.20	0.00	10,921.20	825.38	-10,095.82
04520	04520 - RRUGET RURALE	19,463.31	45,802.12	45,802.12	0.00	45,802.12	29,493.66	-16,308.46
09120	09120 - ARSIMI PARASHKOLLOR	125,467.00	134,854.17	134,854.17	0.00	134,854.17	83,731.20	-51,122.97
09230	09230 - KONVIKTI DHE ARSIMI I MESEM	19,186.21	40,140.34	40,140.34	0.00	40,140.34	15,931.72	-24,208.62
10430	10430 - KUJDESI SOCIAL	798,621.43	433,554.07	741,445.07	0.00	741,445.07	592,644.85	-148,800.22
01620	Fonde komisioner & numerues	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
01620	Fonde materiale zgjedhore	0.00	409.00	2,964.00	0.00	2,964.00	2,580.75	-383.25
09240	Bursa Arsimi profesional	211.65	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
03280	Emergjenca civile: Fonde qeverisese	3,861.13	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
06370	Projekte UKK	2,045.12	71,558.58	71,558.58	0.00	71,558.58	0.00	-71,558.58
Totali i Shpenzimeve të Njësisë		**1,470,067.98**	**1,228,960.97**	**1,570,200.12**	**0.00**	**1,570,200.12**	**1,051,853.41**	**-518,346.71**



Gjithashtu në hartimin e raportit mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas artikujve buxhetor, kemi përdorur tabelat e anekseve përkatëse dhe ilustrimet me grafiqet si më poshtë dhe bashkë me to dhe relacionin shpjegues të shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas artikujve buxhetor apo siç njihen ndryshe në raportim aneksi nr.2 dhe shtojca nr.2.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	.....						Kodi i Programit	.....
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buzheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buzheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buzheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buzheti	Fakti	
600	Paga	374,460.85	415,081.44	417,382.53	-	417,382.53	267,924.97	(149,457.56)
601	Sigurime Shoqërore	64,890.65	76,272.58	76,272.58	-	76,272.58	45,882.99	(30,389.59)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	174,978.15	154,781.86	167,268.63	-	167,268.63	76,170.22	(91,098.41)
603	Subvencione	-		-	-	-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme	3,861.13		-	-	-	20.42	20.42
605	Transferta Korente të Huaja	-		-	-	-	-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	798,026.63	429,817.96	737,962.87	-	737,962.87	589,284.87	(148,678.00)
Nen-Totali	*Shpenzime Korrente*	1,416,217.41	1,075,953.84	1,398,886.61	-	1,398,886.61	979,283.47	(419,603.14)
230	Kapitale të Patrupëzuara	2,045.12	11,054.57	11,054.57	-	11,054.57	-	(11,054.57)
231	Kapitale të Trupëzuara	51,805.45	141,952.54	160,258.94	-	160,258.94	15,262.40	(144,996.54)
232	Transferta Kapitale			-	-	-	-	-
Nen - Totali	*Shpenzime Kapitale me financim te brendshem*	53,850.57	153,007.11	171,313.51	-	171,313.51	15,262.40	(156,051.11)
230	Kapitale të Patrupëzuara	-		-	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-		-	-	-	57,307.54	57,307.54
232	Transferta Kapitale	-		-	-	-	-	-
Nen - Totali	*Shpenzime Kapitale me financim te huaj*	-		-	-	-	57,307.54	57,307.54
Totali	Shpenzime Kapitale	53,850.57	153,007.11	171,313.51	-	171,313.51	72,569.94	(98,743.57)
Totali (korrente + kapitale)		1,470,067.98	1,228,960.95	1,570,200.12	-	1,570,200.12	1,051,853.41	(518,346.71)



Relacion shpjegues i shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas programeve (Shtojca 2)

Të dhënat e grafikut të mëposhtëm për programin **01110- Menaxhim, Administrimi** tregojnë realizimin, masën e realizimit të objektivave dhe qëllimeve në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Ndërtim i administratës së Bashkisë së Kukësit në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësive ndaj qytetarëve.
- Burime njerëzore të trajnuara për kryerjen e funksioneve vendore.
- Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e administratës së Bashkisë Kukës.
- Likuidimi i detyrimeve financiare të Bashkisë ndaj të tretëve.
- Ofrim cilësor i shërbimeve i të gjitha administrative.
- Nxitja e punësimit të rinjve, vajza dhe djem përmes lehtësimit të proçedurave të regjistrimit të bizneseve dhe zvogëlimi i burokracive tatimore.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Organet ekzekutive dhe legjislative, Çështjet financiare dhe fiskale, Çështjet e brendshme						Kodi i Programit	01110
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	158,530.23	190,703.33	190,539.42	-	190,539.42	117,830	(72,709.34)
601	Sigurime Shoqërore	29,548.09	33,754.15	33,754.15	-	33,754.15	21,522.55	(12,231.60)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	84,786.35	48,178.73	48,432.88	-	48,432.88	30,254.97	(18,177.91)
603	Subvencione				-	-		-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	20.42	20.42
605	Transferta Korente të Huaja				-	-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,105.77	106.50	271.41	-	271.41	107.50	(163.91)
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	273,970.44	272,742.71	272,997.86	-	272,997.86	169,735.52	(103,262.34)
230	Kapitale të Patrupëzuara		1,500.00	1,500.00		1,500.00		(1,500.00)
231	Kapitale të Trupëzuara	2,100.25	9,620.61	9,620.61		9,620.61	950.40	(8,670.21)
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	2,100.25	11,120.61	11,120.61	-	11,120.61	950.40	(10,170.21)
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				-	-		-
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	-	-	-	-	-	-	-
Totali	Shpenzime Kapitale	2,100.25	11,120.61	11,120.61	-	11,120.61	950.40	(10,170.21)
Totali (korrente + kapitale)		276,070.69	283,863.32	284,118.47	-	284,118.47	170,685.92	(113,432.55)



	Paga	Sigurime Shoqërore	Mallra dhe Shërbime të Tjera	Trans per Buxh. Fam. & Individ	Kapitale të Trupëzuara
Buxheti	190,539.42	33,754.15	48,432.88	271.41	9,620.61
Fakti	117,830	21,522.55	30,254.97	107.50	950.40
Përqindja	61.8	63.8	62.5	39.6	9.9

Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë 170,685.92 mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **60.1%**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 117,830 mijë lekë, sigurime shoqërore 21,522.55 mijë lekë, mallra dhe shërbime të tjera 30,254.97 mijë lekë, transferime për buxhetin familjar 107.50 mijë lekë, investime kapitale 950.40 mijë lekë.

Për programin **06260- Shërbimet publike** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, përmes mjediseve të pastra.
- Sigurimi i mjediseve të gjelbëruar.
- Përmirësimi i cilësisë së dekorit, përshtatja me trendin e kohës, përdorimi i shumëfishtë i tij në të gjithë territorin e Bashkisë Kukës.
- Rritja e cilësisë së jetës së banorëve të qytetit dhe zonave rurale, lehtësimi i lëvizjes së vajzave dhe grave gjatë orëve të mbrëmjes.
- Nxitja e zhvillimit industrial në Bashkinë Kukës përmes ngritjes së infrastrukturës.
- Krijimi i një sistemi adresash të saktë për të gjithë territorin e Bashkisë Kukës si mjet për përmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit.
- Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes së varrezave publike.
- Përmirësimi i cilësisë së transportit të administratës në ofrimin e shërbimeve publike

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Shërbimet Publike bazë						Kodi i Programit	06260
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buzheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buzheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buzheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buzheti	Fakti	
600	Paga	45,208.61	42,177.44	42,147.44		42,147.44	29,686.71	(12,460.73)
601	Sigurime Shoqërore	6,725.14	6,429.16	6,430.16		6,430.16	4,704.11	(1,726.05)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	66,487.42	35,659.28	47,891.88		47,891.88	23,284.47	(24,607.41)
603	Subvencione					-		-
604	Transferta Korente të Brendshme					-		-
605	Transferta Korente të Huaja					-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	171.10		30.00		30.00		(30.00)
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	118,592.27	84,265.88	96,499.48	-	96,499.48	57,675.29	(38,824.19)
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara	31,639.99	40,980.80	59,287.20		59,287.20		(59,287.20)
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	31,639.99	40,980.80	59,287.20	-	59,287.20	-	(59,287.20)
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-	57,307.54	57,307.54
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	-	-	-	-	-	57,307.54	57,307.54
Totali	Shpenzime Kapitale	31,639.99	40,980.80	59,287.20	-	59,287.20	57,307.54	(1,979.66)
Totali (korrente + kapitale)		150,232.26	125,246.68	155,786.68	-	155,786.68	114,982.83	(40,803.85)



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **114,982.83** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **73.8 %** të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 29,686.71 mijë lekë, sigurime shoqërore 4,704.11 mijë lekë, mallra dhe shërbime të tjera 23,284.47 mijë lekë.

Për programin **01170- Shërbimi i gjendjes civile** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Ofrimi i një shërbimi cilësor të Gjendjes Civile përmes lëshimit në kohë të dokumenteve bazë siç mund te jenë:
  a) çertifikata e lindjes;
  b) çertifikata martesore;

c) çertifikata familjare;
d) çertifikata e vdekjes;
e) dokumenta për letërnjoftimi dhe pasaporta;
f) vërtetime banimi, etj.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Gjendja Civile						Kodi i Programit	01170
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	7,093.38	7,350.00	7,350.00		7,350.00	4,797.94	(2,552.06)
601	Sigurime Shoqërore	1,100.00	1,100.00	1,100.00		1,100.00	800.09	(299.91)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	182.00				-		-
603	Subvencione					-		-
604	Transferta Korente të Brendshme					-		-
605	Transferta Korente të Huaja					-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,730.00				-		-
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	11,105.38	8,450.00	8,450.00	-	8,450.00	5,598.03	(2,851.97)
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	-	-	-	-	-	-	-
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	-	-	-	-	-	-	-
Totali	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Totali (korrente + kapitale)		11,105.38	8,450.00	8,450.00	-	8,450.00	5,598.03	(2,851.97)



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **5,598.03** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **66.2 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 4,797.94 mijë lekë, sigurime shoqërore 800.09 mijë lekë.

Për programin **<u>03280- Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi</u>** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Krijimi i skemës funksionale të burimeve njerëzore dhe logjistike për menaxhimin mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin si dhe plotësimi i kushteve të sigurisë për mbrojtjen kundër zjarrit për të gjithë objektet në pronësi të Bashkisë Kukës.
- Ofrimi i një shërbimi të qëndrueshëm për emergjencat civile në çdo pjesë të territorit të Bashkisë Kukës përmes ngritjes së strukturës së vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme e strukturave të mbrojtjes civile.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi						Kodi i Programit	03280
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	33,981.62	39,994.61	39,964.61	-	39,964.61	22,262.56	(17,702.05)
601	Sigurime Shoqërore	5,661.50	7,035.24	7,035.24	-	7,035.24	3,712.17	(3,323.07)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,179.94	10,439.57	10,439.57	-	10,439.57	2,003.00	(8,436.57)
603	Subvencione				-	-		-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-		-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			30.00	-	30.00	30.00	-
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	***41,823.06***	***57,469.42***	***57,469.42***	**-**	**57,469.42**	***28,007.73***	**(29,461.69)**
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem***	-	-	-	-	-	-	-
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				-	-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	-	-	-	-	-	-	-
Totali	**Shpenzime Kapitale**	-	-	-	-	-	-	-
Totali (korrente + kapitale)		**41,823.06**	**57,469.42**	**57,469.42**	**-**	**57,469.42**	**28,007.73**	**(29,461.69)**



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **28,007.73** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **48.7 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 22,262.56 mijë lekë, sigurime shoqërore 3,712.17 mijë lekë, mallra dhe shërbime të tjera 2,003.00 mijë lekë, transferime per buxhetin familjar dhe individual 30.00 mije leke .

Në planet për emergjencat civile që hartohen bazuar në strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore, kapacitetet e mbrojtjes

civile, edhe përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive, përfshihen edhe financimet nga qeveria për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore në Bashkinë Kukës, që për vitin 2021 nuk janë bërë akoma shpenzime për këtë program.

Për programin **<u>04130- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)</u>** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- QKB në Bashkinë Kukës përmirëson klimën e biznesit duke lehtësuar procedurat për regjistrim;
- QKB mundëson aplikimin online për regjistrimin e biznesit dhe për një sërë shërbimesh.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Qendra Kombetare e Biznesit						Kodi i Programit	04130
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	1,123.80	1,248.00	1,248.00	-	1,248.00	817.61	(430.39)
601	Sigurime Shoqërore	187.67	227.00	227.00	-	227.00	136.54	(90.46)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	22.00	100.00	100.00	-	100.00		(100.00)
603	Subvencione				-	-		-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-		-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ				-	-		-
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	***1,333.47***	***1,575.00***	***1,575.00***	-	1,575.00	***954.15***	(620.85)
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem***	-	-	-	-	-	-	-
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				-	-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	-	-	-	-	-	-	-
Totali	**Shpenzime Kapitale**	-	-	-	-	-	-	-
Totali (korrente + kapitale)		**1,333.47**	**1,575.00**	**1,575.00**	-	**1,575.00**	**954.15**	**(620.85)**



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **954.15** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **60.6 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 817.61 mijë lekë dhe sigurime shoqërore 136.54 mijë lekë.

Për programin **<u>04240- Ujitja dhe Kullimi</u>** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave;
- Ndërtimi i veprave të reja të infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit;
- Menaxhimi i institucionit në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Ujitja dhe Kullimi						Kodi i Programit	04240
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	1,021.19	1,512.93	8,439.89		8,439.89	4,513.34	(3,926.55)
601	Sigurime Shoqërore	170.54	351.90	1,425.79		1,425.79	753.17	(672.62)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,039.25	7,833.24	5,196.77		5,196.77	1,098.06	(4,098.71)
603	Subvencione					-		-
604	Transferta Korente të Brendshme					-		-
605	Transferta Korente të Huaja					-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			52.62		52.62	52.62	-
Nen-Totali	*Shpenzime Korrente*	*5,230.98*	*9,698.07*	*15,115.07*	-	15,115.07	*6,417.19*	(8,697.88)
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara	6,639.95	*1,223.13*					-
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen -Totali	*Shpenzime Kapitale me financim te brendshem*	*6,639.95*	*1,223.13*	-	-	-	-	-
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				-	-		-
Nen -Totali	*Shpenzime Kapitale me financim te huaj*	-	-	-	-	-	-	-
Totali	Shpenzime Kapitale	6,639.95	1,223.13	-	-	-	-	-
Totali (korrente + kapitale)		11,870.93	10,921.20	15,115.07	-	15,115.07	6,417.19	(8,697.88)



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **6,417.19** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **42.5 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 4,513.34 mijë lekë, sigurime shoqërore 753.17 mijë lekë, mallra dhe shërbime të tjera 1,098.06 mijë lekë.

Për programin **<u>04260- Menaxhimi i pyjeve</u>** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Regjistrimin e fondit pyjor dhe kullosor në ZRPP;
- Rehabilitim, pyllëzim dhe ripyllëzim të sipërfaqeve, të degraduara, djegura dhe rehabilitimin e kullotave.
- Evidentimi per zjarret e rënë në pyjet dhe kullotat që administrojnë apo kanë në pronësi dhe raportim per të dhënat statistikore, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore.
- Parandalimi i gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullosore.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar – Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Shërbimi Pyjor						Kodi i Programit	04260
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	7,243.46	8,439.89	1,512.93	-	1,512.93	696.98	(815.95)
601	Sigurime Shoqërore	1,201.94	1,425.79	351.90	-	351.90	116.40	(235.50)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	330.94	5,196.77	7,833.24	-	7,833.24	12.00	(7,821.24)
603	Subvencione				-	-		-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-		-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		52.62		-	-		-
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	***8,776.34***	***15,115.07***	***9,698.07***	***-***	***9,698.07***	***825.38***	***(8,872.69)***
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara			1,223.13		1,223.13		(1,223.13)
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem***	***-***	***-***	***1,223.13***	***-***	***1,223.13***	***-***	***(1,223.13)***
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				-	-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	***-***	***-***	***-***	***-***	***-***	***-***	***-***
Totali	**Shpenzime Kapitale**	**-**	**-**	**1,223.13**	**-**	**1,223.13**	**-**	**(1,223.13)**
Totali (korrente + kapitale)		**8,776.34**	**15,115.07**	**10,921.20**	**-**	**10,921.20**	**825.38**	**(10,095.82)**



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **852.38** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **7.6 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 696.98 mijë lekë, sigurime shoqërore 116.40 mijë lekë, mallra dhe shërbime të tjera 12.00 mijë lekë.

Për programin **04520- Rrugët rurale** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Përmirësimi i rrjetit të rrugëve vendore dhe trotuareve në Bashkinë Kukës.
- Lehtësimi i lëvizjes së banorëve të qytetit përmes rehabilitimit të infrastrukturës rrugore vendore.
- Nxitja e turizmit në rajon përmes ndërtimit të infrastrukturës rrugore strategjike.
- Lehtësimi i lidhjes së banorëve të bashkisë me pikat e kalimit ndërkombëtar.
- Lehtësimi i lëvizjes së banorëve në zonat rurale të bashkisë përmes pastrimit të rrugëve nga dëbora.
- Lehtësimi i lëvizjes së banorëve në zonat rurale të bashkisë përmes rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar - Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Rrugët Rurale						Kodi i Programit	04520
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	2,986.68	6,208.25	6,208.25	-	6,208.25	2,074.18	(4,134.07)
601	Sigurime Shoqërore	830.54	646.12	646.12	-	646.12	346.22	(299.90)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	15,646.09	26,635.73	26,635.75	-	26,635.75	14,761.26	(11,874.49)
603	Subvencione				-	-		-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-		-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ				-	-		-
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	***19,463.31***	***33,490.10***	***33,490.12***	***-***	***33,490.12***	***17,181.66***	***(16,308.46)***
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara		12,312.00	12,312.00		12,312.00	12,312.00	-
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem***	***-***	***12,312.00***	***12,312.00***	***-***	12,312.00	***12,312.00***	-
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				-	-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	***-***	***-***	***-***	***-***	-	***-***	-
Totali	***Shpenzime Kapitale***	***-***	***12,312.00***	***12,312.00***	***-***	***12,312.00***	***12,312.00***	***-***
Totali (korrente + kapitale)		***19,463.31***	***45,802.10***	***45,802.12***	***-***	***45,802.12***	***29,493.66***	***(16,308.46)***



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **29,493.66** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **64.4 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 2,074.18 mijë lekë, sigurime shoqërore 346.22 mijë lekë, mallra dhe shërbime të tjera 14,761.26 mijë lekë dhe investime kapitale 12,312.00 mijë lekë

Për programin **09120- Arsimi Parashkollor** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve për arsimin dhe zhvillimi e shfrytëzimi cilësor i infrastrukturës së institucioneve arsimore në Bashkinë Kukës.
- Rritja e cilësisë së jetës kulturore e sportive të bashkisë.
- Zhvillimi i talenteve të reja në fushën e artit dhe kulturës si dhe pasurimi e gjallërimi i jetës kulturore e artistike.
- Promovimi i nxënësve të dalluar në mësime përmes aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.
- Përfshirja e të rinjve në aktivitete rinore me tematika të ndryshme.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes ngritjes/rehabilitimit të infrastrukturës arsimore rishpërndarja më optimale e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit të Kukësit.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar – Gusht 2021

ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Arsimi bazë parauniversitar						Kodi i Programit	09120
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	97,689.27	97,281.23	97,251.23		97,251.23	70,037.01	(27,214.22)
601	Sigurime Shoqërore	16,232.66	21,820.36	21,820.36		21,820.36	11,623.18	(10,197.18)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		6,322.19	6,322.19		6,322.19		(6,322.19)
603	Subvencione							-
604	Transferta Korente të Brendshme					-		-
605	Transferta Korente të Huaja					-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	147.41	40.88	71.88		71.88	71.01	(0.87)
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	***114,069.34***	***125,464.66***	***125,465.66***	**-**	***125,465.66***	***81,731.20***	***(43,734.46)***
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara	*11,397.66*	*9,388.51*	*9,388.51*		9,388.51	*2,000.00*	(7,388.51)
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem***	***11,397.66***	***9,388.51***	***9,388.51***	**-**	9,388.51	***2,000.00***	(7,388.51)
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				**-**	-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	**-**	**-**	**-**	**-**	-	**-**	-
Totali	**Shpenzime Kapitale**	**11,397.66**	**9,388.51**	**9,388.51**	**-**	**9,388.51**	**2,000.00**	**(7,388.51)**
Totali (korrente + kapitale)		**125,467.00**	**134,853.17**	**134,854.17**	**-**	**134,854.17**	**83,731.20**	**(51,122.97)**



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **83,731.20** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **62.1 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga 70,037.01 mijë lekë, sigurime shoqërore 11,623.18 mijë lekë, transferime për buxhetin familjar 71.01 mijë lekë, investime kapitale 2,000.00 mijë lekë.

Për programin **09230- Arsimi Parauniversitar dhe Konvikti** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve për arsimin e mesëm dhe konviktin dhe zhvillimi e shfrytëzimi cilësor i infrastrukturës së institucioneve arsimore për arsimin e mesëm dhe konviktin në Bashkinë Kukës.
- Rritja e cilësisë së jetës kulturore e sportive të bashkisë.
- Zhvillimi i talenteve të reja në fushën e artit dhe kulturës si dhe pasurimi e gjallërimi i jetës kulturore e artistike.
- Promovimi i nxënësve të dalluar në mësime përmes aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.
- Përfshirja e të rinjve në aktivitete rinore me tematika të ndryshme.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies për arsimin e mesëm dhe konviktin përmes ngritjes/reabilitimit të infrastrukturës arsimore rishpërndarja më optimale e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit të Kukësit.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar – Gusht 2021 — ne 000/leke

Bashkia	Kukës						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2125001
Programi	Arsimi i mesëm dhe Konvikti						Kodi i Programit	09230
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
						Buxheti	Fakti	
600	Paga	15,119.52	16,774.85	16,774.85	-	16,774.85	9,898.66	(6,876.19)
601	Sigurime Shoqërore	2,505.30	2,898.05	2,898.05	-	2,898.05	1,648.99	(1,249.06)
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,304.16	14,007.35	14,007.35		14,007.35	4,347.46	(9,659.89)
603	Subvencione				-	-		-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-		-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-		-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	229.63	35.61	36.61		36.61	36.61	-
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	***19,158.61***	***33,715.86***	***33,716.86***	**-**	**33,716.86**	***15,931.72***	**(17,785.14)**
230	Kapitale të Patrupëzuara					-		-
231	Kapitale të Trupëzuara	27.60	6,423.48	6,423.48		6,423.48		(6,423.48)
232	Transferta Kapitale					-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem***	***27.60***	***6,423.48***	***6,423.48***	**-**	6,423.48	**-**	(6,423.48)
230	Kapitale të Patrupëzuara				**-**	-		-
231	Kapitale të Trupëzuara					-		-
232	Transferta Kapitale				**-**	-		-
Nen - Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	**-**	**-**	**-**	**-**	-	**-**	-
Totali	***Shpenzime Kapitale***	***27.60***	***6,423.48***	***6,423.48***	**-**	***6,423.48***	**-**	***(6,423.48)***
Totali (korrente + kapitale)		**19,186.21**	**40,139.34**	**40,140.34**	**-**	**40,140.34**	**15,931.72**	**(24,208.62)**



Për periudhën tetë mujore Janar – Gusht 2021, sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe 8 - mujore janë: **15,931.72** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **39.7 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga

9,898.66 mijë lekë, sigurime shoqërore 1,648.99 mijë lekë, mallra dhe shërbime të tjera 4,347.46 mijë lekë, transferime për buxhetin familjar 36.61 mijë lekë.

Për programin **10430- Kujdesi Social** në raport me objektivat e ketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Mbështetja financiare e shtresave në nevojë përmes përfshirjes së tyre në projekte për Ndihmën Ekonomike dhe Paaftësinë.
- Mbështetja financiare e shtresave në nevojë përmes ndërtimit të banesave për strehim social.
- Ofrimi i shërbimit të strehimit për familjet e pastreha në Bashkinë e Kukësit.
- Nxitja e punësimit të rinjve, vajza dhe djem përmes trajnimeve profesionale në fusha të ndryshme.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Periudha Janar – Gusht 2021 — ne 000/leke

